

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** *Rehabilitim prita malore në infrastrukturën e dëmtuar Zëmbllak e Plasë*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **45210000-2**

**PËRCAKTIMI DHE ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventive dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga grupi qe ka hartuar edhe projekt/ preventivin perkates te zbatimit specialiste te fushës ne bashkepunim me Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit ne bashkine Maliq. *Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë kontrolluar dhe jane gjetur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.*Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve/Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike,argumentimi i numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve dhe makinerive për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**66.170.738,1** (*gjashtëdhjet e gjashtë milion e njëqind e shtatëdhjet mijë e shtatëqind e tridhjet e tetë presje një*)lekë pa tvsh

**79.404.885,8** (*shtatëdhjet e nëntë milion e katërqind e katër mijë e tetëqind e tetëdhjet e pesë presje tetë*)lekë me tvsh

**Likuidimi sipas viteve :**

Viti 2024 **28.409.434,2** (*njëzet e tetë milion e katërqind e nëntë mijë e katërqind e tridhjet e katër presje dy*) lek me tvsh

Viti 2025 **50.995.451,6** (*pesëdhjet milion e nëntëqind e nëntëdhjet e pesë mijë e katërqind e pesëdhjet e një presje gjashtë*)lek me tvsh

Fondi Limit i perlloritur per kete procedure eshte hartuar sipas manualit teknik per vitin 2024, në zbatim të urdhërit të brendshëm të titullarit të AK “Mbi Përgatitjen e kriterëve Teknike dhe Përlloraritjen e Vlerës Limit të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve, bazuar ne dokumentat sipas buxhetit te bashkise te vitit 2024 të miratuara nga Këshilli Bashkiak si dhe dokumentave lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Maliq**\_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Deklarata për mjetet dhe punonjësit është e nevojshme për arsye se punimet duhet të realizohen në cilësi dhe afat të kërkuar sipas dës.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1 Per kapacitetin ligjor /profesional te operatoreve ekonomike:**

Sipas kritereve të përgjithshme të Pranim / Kualifikimit.

*Operatori ekonomik duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi, të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe vërtetuar nëpërmjet ekstraktit të regjistrimit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2021,2022,2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijn ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijn ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku*

*përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

**2.2.2** Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësisë të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitin 2024 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.**

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3 Kapaciteti teknik:”**

2.3.1 a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet ,dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

## Ose

- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e puneve te kryera, e marre se bashku gjate pese viteve te fundit te jete jo me e vogel se fondi limit i kontrates qe prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*\*Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat.40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

### **2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: Operatori ekonomik duhet të dorëzojë:**

#### **a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:**

1. NP 1 - A ( Punime gërmimi në tokë)
2. NP 4 - A (Punime rrugë, autostrada)
3. NP 9 - A (Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime)
4. NS 18 – A ( Punime topogjeodezike )

*\*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te dorezoje licencat profesionale sipas zerave te preventivit qe ne baze te marreveshjes se bashkepunimit merr persiper te realizoje).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Pershkrimi I kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikasi mit i kërkuar për kategori në respektiv e	Vlera e punimeve (pa tvsh) që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1	<i>(Punime gjurmimi në tokë)</i>	Gjurmim kanalësh, gjurmim dheu	A	
NP 4	<i>Punime rrugë, autostrada</i>	Punime shtresash ne rruge	A	
NP 9	<i>Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime</i>	Punime kub ne rruge, punime prita lumore	A	
NS 18	<i>Punime topogjeodezike</i>	Punime per matjen e kuotave te kanaleve dhe shtresave te rrugeve	A	

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një **Deklarate (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë te përfshirë në licensën e shoqërisë. Drejtuesi teknik duhet të jete :

- **Inxhinier Ndertimi (1)**

*“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :*

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

**Argumentimi:** Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162,“Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c.

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

*Inxhinieri i ndërtimit është i nevojshëm për shkak të objektit të punës publike që prokurohet*

*Inxhinieri ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt*

**2.3.4** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Gjeodet (1)

*“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :*

1. Kontratë pune (e vlefshme)
2. Diplomë

**Argumentimi:** Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. dhe 2.3.4 Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162,“Për Prokurimin Publik” datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 “për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6 c.Duke marrë parasysh natyrën e punimeve është kërkuar që drejtuesi teknik të jetë inxhinier ndërtimi.Përsa I përket stafit mbështetës eshte kërkuar :

Inxhinieri hidroteknik sipas zerave te punimeve per punime rikonstruksionin e kanaleve.

Inxhinieri gjeodet sipas zerave per punime shtresash ne rruge per matjen e kuotave ne rruge dhe kanale,duke qene se eshte kerkuar dhe licence per punime topogjeodezike.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të deklarojë sipas formularit të vetdeklarimit se ka një punonjës i cili është i pajisur me Çertifikate trajnimi për *“Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë,ky kusht quhet i plotësuar edhe kur vetem 1 operator ekonomik paraqit dokumentat per punonjesin te pajisur me certifikate trajnimi për “Pergjegjes per*

*sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Pune”.*

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

**2.3.6** Shoqëria duhet të paraqesë Çertifikata ISO të vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
3. ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

*Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

*Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë” , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për “Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso .*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 34 punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- **Manovrator (4)**

*“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

**Kur mjetet, janë në pronësi**

1. kontrata e punës (e vlefshme)
2. Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor

**Kur mjetet, janë me qera**

*Deklarate nga operatori ekonomik, që në rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me manovratorin( i cili duhet të ketë Dëshmi Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve të Transportit Rrugor ) deri në perfundimin e afateve të kontrates.*

- **Murator (10)**
- **Karpentier (5)**
- **Hekurkthyes (2)**
- **Hidraulik (1)**

*“Për punonjësit e mësipërm . “Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);  
ose  
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

- **Punetore të thjeshte (12)**

*“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :*

1. kontrata e punës e vlefshme;

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.



Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të prcktuar 8 muaj i cili kërkon fuqi punëtore dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

Manovrator (4) janë kerkuar bazuar në zerat e preventivit për germim dhe me eskavator si dhe për drejtimin e autovincit, grejderit, asfaltoshtrueses dhe rulit.

Murator (10) janë kerkuar 10 muratore për ndertimin e mureve të gurit, bordurave dhe puseve..

Karpentier (5) janë kerkuar bazuar në zerat e preventivit për fy hekur betoni, muret e betonit, struktura të monolite betoni

Hekurkthyes (2) janë kerkuar 2 hekurkthyes për soletonet dhe muret sipas zerave në preventiv .

Punonjes të thjeshtë (12) janë kerkuar 12 punonjes për punime të ndryshme sipas të gjitha zerave në preventiv.

Hidraulik (1) është kerkuar 1 hidraulik për vendosjen e tubove në punimet për rrugë sipas preventivit.

**2.3.8** Një punësim mesatar i të paktën 34 (tridhjet e kater) punonjësish për muajin e fundit.

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.

**Dhe**

- b. **Listpagesat** e konfirmuar (me firmë dhe vule) nga Administrata Tatimore të punonjesve sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

*Kriteret e percaktuara në piken 2.3.8. Është kerkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 34 punonjësish për të realizuar punimet ,nga zberthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.629, datë 15.07.2015 ”Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre ” Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pka 6, gërma “ç”.*

*Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.*

*Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 34 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda afatit, mbështetur kjo në VKM Nr.629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërket që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është percaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e*

kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" sipas së cilës: "Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës".

### **ZBERTHIMI I PREVENTIVIT**

OBJEKTI:REHABILITIM PRITA MALORE NE INFRASTRUKTUREN E DENTUAR ZEMBLAK DHE PLASE

POROSITESI: BASHKIA MALIQ

PROJEKTUESI: ING.PANAJOT PILANI

PRILL 2024

<b>N R</b>	<b>ANALIZ A</b>	<b>PERSHKRIMI I PUNIMEVE</b>	<b>NJESI A</b>	<b>SASI A</b>	<b>OP/NJ</b>	<b>OP/ GJITH</b>
<b>A.MBROJTJA,SISTEMIMI I ZEMBLAK I LAGJES SE PERMBYTUR NGA PERROI FSHATI ZEMBLAK</b>						
<b>I.Ndertimi i pritave te reja dhe rikonstruksion i pritave egzistuese</b>						
<b>Prita Nr.1</b>						
1	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel dhe shpatullat e pritës	m3	58	3.8	220.4
2	3.323	Mur guri mbajtes e themele,llaç çimento M-50	m3	85.2	9.3	792.4
3	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	3.2	18.76	60.0
<b>SHUMA 1</b>						<b>1072.8</b>
<b>Prita Nr.2</b>						
1	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel dhe shpatullat e pritës	m3	35.4	3.8	134.5
2	3.323	Mur guri mbajtes e themele,llaç çimento M-50	m3	69.8	9.3	649.1
3	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	3.5	18.76	65.7
<b>SHUMA 2</b>						<b>849.3</b>
<b>Prita Nr.3</b>						
1	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel dhe shpatullat e pritës	m3	44.8	3.8	170.2
2	3.323	Mur guri mbajtes e themele,llaç çimento M-50	m3	82.2	9.3	764.5
3	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	3.4	18.76	63.8
<b>SHUMA 3</b>						<b>998.5</b>
<b>Prita Nr.1E</b>						
1	2.430/1	Prishje mur guri strukture e dentuar	m3	50	1	50.0
2	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel dhe shpatullat e pritës	m3	45.6	3.8	173.3
3	3.323	Mur guri mbajtes e themele,llaç çimento M-50	m3	98.7	9.3	917.9
4	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	10.2	18.76	191.4
5	3.110/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 1.0 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	2558	0.04	102.3
6	2.37/5a	Transport dheu distance 5 km	m3	2558	0.1	255.8
<b>SHUMA 4</b>						<b>1690.7</b>
<b>Prita Nr.2E</b>						

1	2.430/1	Prishje mur guri strukture e demtuar	m3	50	1	50.0
2	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel muri mbrojtës	m3	11.2	3.8	42.6
3	2.237	Mur butobetoni 25% gure C-16/20	m3	42.8	9.3	398.0
4	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	9.27	18.76	173.9
5	3.110/b	Gërmim dheu me ekskavator zingjir, 1.0 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	360	0.04	14.4
6	2.37/5a	Transport dheu distance 5 km	m3	360	0.1	36.0
		<b>SHUMA 5</b>				<b>714.9</b>
		<b>Nyja prita 2E-3E</b>				
1	2426/3	Prishje strukture betoni ura egzistuese	m3	8	1.75	14.0
2	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel muri mbrojtës	m3	76	3.8	288.8
3	2.112	Mur betoni C-16/20 kanal	m3	46	15.3	703.8
		<b>SHUMA 6</b>				<b>1006.6</b>
		<b>Ure HD 3m,L-5m</b>				
1	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel muri mbrojtës	m3	15.8	3.8	60.0
2	2.19	Mbushje me dhe te ngjeshur	m3	5.9	1.25	7.4
3	3.396	Mbushje me çakell	m3	3.2	1.25	4.0
4	2.112	Beton C-16/20 per muret	m3	19	15.3	290.7
5	2.262/4	Mbishtrere betoni C-16/20,t=4-8cm	m3	1.44	8.6	12.4
6	2.158/1	Soletone b/a C-20/25	m3	3.96	9.3	36.8
7	3.288	F.V. hekur betoni	kg	508	0.042	21.3
		<b>SHUMA 7</b>				<b>432.7</b>
		<b>Prita 3E+pusi i shuarjes se energjise</b>				
1	2.430/1	Prishje mur guri strukture e demtuar	m3	3.6	1	3.6
2	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel muri mbrojtës	m3	8.8	3.8	33.4
3	3.323	Mur guri mbajtës e themele,llaç çimento M-50	m3	13.8	9.3	128.3
4	2.112	Mur betoni C-16/20 pusi i shuarjes	m3	77.01	15.3	1178.3
5	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	4.37	18.76	82.0
		<b>SHUMA 8</b>				<b>1425.6</b>
		<b>9.Rikonstruksion i kanalit egzistues te largimit te ujrave te perroit te Zemblakut, L=446 m</b>				
1	3.87/a	Gërmime dheu dhe zhavoresh me makineri në kanal të sjella nga përroi Zemblakut	m3	786	0.09	70.7
2	2.430/1	Prishje strukture mur guri i demtuar prej përmytjes	m3	26.8	1	26.8
3	2426/3	Prishje shtresë betoni të bazamentit të shkatërruar nga përmytja, t=10 cm	m3	47	8.6	404.2
4	2.430/1	Prishje mur anësor guri dhe betoni të demtuar anësor në krahun e majtë të rrjedhjes (ana nga rruga)	m3	67	1	67.0
5	3.207/1	Shtresë çakelli t=10 cm nën tabanin e kanalit, L=446 m	m3	48.8	2.9	141.5
6	2.112	Beton C-16/20 për riseksionimin e kanalit të largimit të ujrave, L=446 m	m3	347.8	15.3	5322.6
7	2.166/1a	Hekur betoni për veshjen e mureve dhe bazës te kanalit, H=1.0 m	kg	26448	0.042	1110.8
8	2.122/1	Beton për soletat e mbikalimit të kanalit në zonën e banuar, L=40 m (në zonën e shtëpive te banimit per mbrojtën e fëmijëve) C-16/20	m3	9.6	22.89	219.7
9	3.288	Hekur betoni për soletat e kanalit per 300 ml gjatësi kanali	kg	940	0.042	39.5
10	3.396	Mbushje me makadam anet e kanalit 0.5x0.7m	m3	312	1.25	390.0
11	An	F.V. tuba HDPE te brinjezuar SN8 D=200	ml	346	0.1	34.6
		<b>SHUMA 9</b>				<b>7827.5</b>
		<b>10.Ndertim ura HD 1.5m,L=32ml</b>				
1	3.67/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor për themel muri mbrojtës	m3	83.84	3.8	318.6
2	2.19	Mbushje me dhe te ngjeshur	m3	28.16	1.25	35.2
3	3.396	Mbushje me çakell	m3	19.2	1.25	24.0

4	2.112	Beton C-16/20 per muret	m3	98.4	15.3	1505.5
6	2.123/1	Solete monolite b/a C-16/20	m3	10.24	9.3	95.2
7	3.288	F.V. hekur betoni	kg	1261	0.042	53.0
		<b>SHUMA 10</b>				<b>2031.5</b>
		<b>11.Rikonstruksion i rrugëve përgjate kanalit</b>				
1	3.104/a	Gërmim dheu me ekskavator 0.5 m3,shkarkim ne mjet	m3	268	0.06	16.1
2	3.207/1	Shtrese çakelli poshte kalldremit,t=10cm	m3	370	0.045	16.7
3	An	Shtrese kalldremit t=20 cm	m2	370	1	370.0
4	An	Bordure guri 15x30 cm	ml	150	0.2	30.0
5	2.290	Bordure betoni 20x35cm	ml	106	0.2	21.2
6	3.212/b	Shtrese stabilizanti t=10 cm	m2	520	0.075	39.0
7	3.222/1	Shtrese binderi t=5 cm	m2	520	0.109	56.7
8	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t=4cm	m2	1450	0.095	137.8
9	2.112	Beton C-16/20 per shkalle	m3	4.2	15.3	64.3
11	2.182	Parapet metalik shkalle	kg	320	0.042	13.4
		<b>SHUMA 11</b>				<b>765.1</b>
		<b>SHUMA A</b>				<b>18815.1</b>
<b>B.MBROJTJA,SISTEMIMI I FSHATIT PLASE TE PERMBYTUR NGA PERRENJTE E FSHATIT PLASE</b>						
		<b>1.Prita Nr.1 kanali I shkarkimit perroi mbi fshat</b>				
1	3.69/a	Gërmim dheu me krahe në formacion gjysëm shkëmbor për themel dhe shpatullat e pritës	m3	48.4	4.9	237.2
2	3.323	Mur guri mbajtes e themele,llaç çimento M-50	m3	85.2	9.3	792.4
3	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	2.1	18.76	39.4
4	2.112	Beton C-16/20 pusi i shuarjes	m3	12.8	15.3	195.8
5	3.69/a	Gërmim dheu në formacion gjysëm shkëmbor me ekskavator 0.25 m3 per kanal dhe rrugë aksesi ne veper	m3	402	4.9	1969.8
6	2.112	Beton C-16/20 kanal		65.4	15.3	1000.6
		<b>SHUMA 1</b>				<b>4235.2</b>
		<b>2.Prita Nr.2 perroi mbi fshat</b>				
1	3.67/a	Gërmim dheu me krahe në formacion gjysëm shkëmbor për themel dhe shpatullat e pritës	m3	14.6	3.5	51.1
2	3.323	Mur guri mbajtes e themele,llaç çimento M-50	m3	44.7	9.3	415.7
3	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	2.24	18.76	42.0
		<b>SHUMA 2</b>				<b>508.8</b>
		<b>3.Prita Nr.1 dhe pusi i shuarjes perroi i madh</b>				
1	3.108/b	Gërmim dheu ekskavator 1 m3 toke kat.3 ne prani te ujit,shkarkim ne toke	m3	119	0.04	4.8
2	2.237	Butobeton 25% gure,C-16/20 muret e pusit	m3	31.4	15.3	480.4
3	3.246	Bazament betoni C-16/20,t=50 cm pusi i shuarjes	m3	39	8.6	335.4
4	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	5.48	18.76	102.8
5	3.164/1a	Mbushje mbrapa murit me dhe te germuar me pare	m3	119	1.25	148.8
		<b>SHUMA 3</b>				<b>1072.1</b>
		<b>4.Prita Nr.2 dhe pusi i shuarjes perroi i madh</b>				
1	3.108/b	Gërmim dheu ekskavator 1 m3 toke,ne prani te ujit, kat.3 shkarkim ne mjet	m3	68	0.04	2.7
2	2.237	Butobeton 30% gure,C-16/20 muret e pusit	m3	30.3	15.3	463.6
3	3.246	Bazament betoni C-16/20,t=50 cm pusi i shuarjes	m3	18.7	8.6	160.8
4	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	2.2	18.76	41.3
5	3.164/1a	Mbushje mbrapa murit me dhe te germuar me pare	m3	26	1.25	32.5
		<b>SHUMA 3</b>				<b>700.9</b>

5.Prita Nr.3 dhe pusi i shuarjes perroi i madh						
1	3.108/b	Gërmim dhe ekskavator 1 m3 toke kat.3,ne prani te ujit, shkarkim ne mjet	m3	68	0.04	2.7
2	2.237	Butobeton 30% gure,C-16/20 muret e pusit	m3	30.3	15.3	463.6
3	3.246	Bazament betoni C-16/20,t=50 cm pusi i shuarjes	m3	18.7	8.6	160.8
4	2.121	Brez betoni C-16/20,t=20 cm	m3	2.2	18.76	41.3
5	3.164/1a	Mbushje mbrapa murit me dhe te germuar me pare	m3	26	1.25	32.5
<b>SHUMA 5</b>						<b>700.9</b>
<b>6.Veshja e perroit</b>						
1	3.108/b	Gërmim dhe ekskavator 1 m3 toke kat.3,ne prani te ujit, shkarkim ne mjet	m3	1796	0.04	71.8
2	3.207/1	Shtrese zhavori 10 cm	m3	137	2.9	397.3
3	2.237	Butobeton 25% gure,C-16/20 muret	m3	971	15.3	14856.3
4	3.246	Beton C-16/20 bazamenti i perroit	m3	258	8.6	2218.8
5	3.164/1a	Mbushje mbrapa murit dhe sistemim skarpata me dhe te germuar me pare	m3	1268	1.25	1585.0
<b>SHUMA 6</b>						<b>19129.2</b>
<b>Ure HD 4m,L-4m</b>						
1	3.108/b	Gërmim dhe kat.3,prani uji,për themel bazamentet e ures	m3	34	0.04	1.4
2	3.164/1a	Mbushje mbrapa murit me dhe te germuar me pare	m3	14	1.25	17.5
3	3.396	Mbushje me çakell	m3	3.6	1.25	4.5
4	2.112	Beton C-16/20 per muret	m3	25.44	13.3	338.4
5	2.262/4	Mbistrese betoni C-16/20,t=4-8cm	m3	0.84	8.6	7.2
6	2.195	Tre duar bitum	m2	16	0.42	6.7
7	2.264	Shtrese lluster çimento 1:2	m2	16	0.66	10.6
8	3.249	Soletone b/a C-20/25	m3	5.04	3.9	19.7
9	3.288	F.V. hekur betoni	kg	672	0.042	28.2
<b>SHUMA 7</b>						<b>434.1</b>
<b>SHUMA B</b>						<b>26781.3</b>
<b>C.REHABILITIMI I RRUGEVE TE PERMBYTURA ZEMBLAK,PLASE</b>						

**RRUGA 1 L=270 ml B=5 ml**

Nr.	Nr. AN	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
<b>1.PUNIME NE RRUGEN NR.1 ZEMBLAK</b>						
1	2.26	Gërmim dhe me eskavator,goma me gjerësi > 2m,tok zak,kategoria III,me shk në mjet	m <sup>3</sup>	160	0.062	10
2	3.158/1a	Transport materiale ndërtimi,dheu me auto deri 1.0 km	m <sup>3</sup>	160	0.1	16
3	3.207	Shtrese cakulli makadam t = 10cm (bankinat anesore)	m <sup>2</sup>	800	0.045	36
4	3.212/b	Shtresë stabilizanti t=10cm	m <sup>2</sup>	800	0.075	60
5	3.222/1	Shtrese binderi t = 5cm	m <sup>2</sup>	400	0.109	44
6	3.226/1	Shtrese asfaltbetoni t = 4cm	m <sup>2</sup>	1350	0.095	128
<b>SHUMA 1</b>						<b>294</b>

**RRUGA 2 L= 260 ml**

Nr.	Nr. AN	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
<b>2.PUNIME NE RRUGEN NR.2 ZEMBLAK</b>						
1	2.26	Gërmim dhe me eskavator,goma me gjerësi > 2m,tok zak,kategoria III,me shk në mjet	m <sup>3</sup>	90	0.062	6
2	3.158/1a	Transport materiale ndërtimi,dheu me auto deri 1.0 km	m <sup>3</sup>	90	0.1	9
3	3.212/b	Shtresë stabilizanti t=10cm	m <sup>2</sup>	450	0.075	34
4	3.222/1	Shtrese binderi t = 5cm	m <sup>2</sup>	450	0.109	49
5	3.226/1	Shtrese asfaltbetoni t = 4cm	m <sup>2</sup>	1300	0.095	124
6	3.616/a	F.V. Bordura rruge e parafabrikuar 15x25 cm	ml	460	0.2	92
<b>b PUNIME K.U.B NE RRUGE</b>						<b>0</b>

1	2.25	Gërmim dheu me eskavator goma 0.25m <sup>3</sup> , në knale me gjerësi deri në 2m, tokë zakkategoria III, me shk. në toke	m <sup>3</sup>	184	0.062	11
2	An	F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=200mm	ml	460	0.1	46
3	3.47/1a	Mbushje ,rrafshim ngjeshje dheu me tokmak elektrik cdo 30 cm toke e zakonshme	m <sup>3</sup>	145	0.44	64
4	3.158/1a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1.0 km	m <sup>3</sup>	80	0.1	8
5	An-22/1	Ndërtim puseta 40x40, h=100cm me zgare gize per ujrut e shiut	cope	12	4.2	50
		<b>SHUMA 2</b>				<b>492</b>
		<b>3. RRUGA 3 L= 500 ml B=3.5 ml</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Nr. AN</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNIMEVE</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>		<b>Vlera</b>
		<b>PUNIME NE RRUGE</b>				
1	3.207	Shtrese cakulli makadam t = 10cm (bankinat anesore)	m <sup>2</sup>	270	0.045	12
2	3.222/1	Shtrese binderi t = 5cm	m <sup>2</sup>	200	0.109	22
3	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m <sup>2</sup>	1800	0.095	171
		<b>SHUMA 3</b>				<b>205</b>
		<b>4. SISTEMIM ASFALTIM RRUGE FSHATI PLASE</b>				
		<b>L= 300 ml</b>				
<b>Nr.</b>	<b>Nr. AN</b>	<b>PËRSHKRIMI I PUNIMEVE</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>		<b>Vlera</b>
<b>I</b>		<b>PUNIME NE RRUGE</b>				
1	2.26	Gërmim dhe me eskavator, goma me gjerësi > 2m, tok zak, kategoria III, me shk në mjet	m <sup>3</sup>	300	0.062	19
2	3.158/1a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1.0 km	m <sup>3</sup>	300	0.1	30
3	3.207	Shtrese cakulli makadam t = 10cm	m <sup>2</sup>	1550	0.045	70
4	3.212/b	Shtresë stabilizanti t=10cm	m <sup>2</sup>	1550	0.075	116
5	3.222/1	Shtrese binderi t = 5cm	m <sup>2</sup>	1550	0.109	169
6	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni t = 4cm	m <sup>2</sup>	1550	0.095	147
7	3.616/a	F.V. Bordura rruge e parafabrikuar 15x25 cm	ml	610	0.2	122
<b>II</b>		<b>PUNIME K.U.B NE RRUGE</b>				<b>0</b>
1	2.25	Gërmim dheu me eskavator goma 0.25m <sup>3</sup> , në knale me gjerësi deri në 2m, tokë zakkategoria III, me shk. në toke	m <sup>3</sup>	94	0.062	6
2	An	F.V. Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 Dn=200mm	ml	240	0.1	24
3	3.47/1a	Mbushje ,rrafshim ngjeshje dheu me tokmak elektrik cdo 30 cm toke e zakonshme	m <sup>3</sup>	75	0.44	33
4	3.158/1a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1.0 km	m <sup>3</sup>	20	0.1	2
5	An-22/1	Ndërtim puseta 40x40, h=100cm me zgare gize per ujrut e shiut	cope	10	4.2	42
6	An	Ngitje pusetash KUZ	cope	6	4.5	27
7	3.321	Mur me gur mbajtes llac çm M-25	m <sup>3</sup>	25	9.3	233
		<b>SHUMA 4</b>				<b>1,039</b>
		<b>SHUMA C</b>				<b>2030.3</b>
		<b>SHUMA A+B+C</b>				<b>47626.7</b>

- Nga zberthimi i preventivit oret e punes per cdo ze punimi rezultojne 47628.
- Oret në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore 47628: 8 = 5954.  
kemi 5954 punëtorë për një ditë pune
- 5954 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 271 punëtorë për një muaj punë.
- Rezulton 34 punetore shpërndarë sipas grafikut per 8 muaj .

**2.3.9 Operatori ekonomik duhet te kete ne pronesi ose me qira mjetet e domosdoshme per realizimin e kontrates si me poshte :**

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
2. Eskavator me zinxhir	1 copë	Pronësi ose me qera
3. Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
4. motobetoniere	4 copë	Pronësi ose me qera
5. grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
6. rul me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qera
7. asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
8. tokmak elektrik	2 copë	Pronësi ose me qera
9. autobot	1 copë	Pronësi ose me qera
10. autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
11. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 10 ton deri 18 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
12. Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 5 ton deri 7 ton me dy diferenciale	1 copë	Pronësi ose me qera
13. Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 1.5 deri 5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

*( Shenim per kapacitetin mbajtes se mjeteve te kerkuara per realizimin e punimeve.Kapaciteti mbajtes i mjeteve sipas lejes se qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkese te plote te lejuar ne Shqiperi dhe Mases se mjetit bosh.)*

**“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :**

*a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:*

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme
5. Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

*dhe per mjetet me qera,*

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)

4. *Police sigurimi (e vlefshme)*
5. *Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]*
6. *Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia*

*Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatoret ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certifikate e transportit te mallrave ) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.*

**b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :**

*per mjetet ne pronesi :*

- *aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

*per mjetet me qera :*

- *të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.*
- *aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**1- Eskavator me zinxhir**

*eshte kerkuar 1 eskavator me zinxhir sipas zerave ne preventive per germime ne formacione gjysem shekembore dhe terheqje te materialeve per ndertimin e pritave malore .*

**2- Eskavator me goma**

*eshte kerkuar 1 eskavator me goma per germime dheu dhe hedhje ne mjetsipas zerave ne preventive.*

**3- Autovinc**

*eshte kerkuar 1 autovinc per ngritjen e materialeve te ndryshme soletonet etj.*

**1- motobetoniere**

*Bazuar në zërin e preventivit për punime betoni jane kerkuar 4 motobetoniere qe do punojne ne zona te ndryshme .*

**3- grejder**

*Bazuar në zërin e preventivit për punime shtresash ne rruge eshte kerkuar dhe nje grejder per nivelim..*

**4- Rul me vibrim**

*Bazuar në zërin e preventivit për punime shtresash ne rruge eshte kerkuar dhe 1 rul me vibrim per ngjesghje.*

**5- asfaltoshtruese**

*Bazuar në zërin e preventivit për shtresa asfaltobetoni per punime ne rruge eshte kerkuar 1 asfaltoshtruese..*

**6- Tokmak elektrik**

**7- autobot**

*Bazuar në zërin e preventivit për punime betoni eshte kerkuar nje autobot.*

**8- autobitumatrice**



Bazuar në zërin e preventivit për punime shtresash ne rruge eshte kerkuar nje autobitumatrice per sperkatje me bitum..

**9- Kamion me kapacitet mbajtes nga 10-18 ton**

jane kerkuar 2 kamion vetshkarkues per transportin e materialeve te ndryshme si asphalt ,stabilizant etj.Kerkohen 2 makineri pasi punimet shtrihen ne fshatra te ndryshne dhe eshte e nevojshme qe kamionet te jene disponibel ne kohen e duhur per realizimin e sherbimeve..

**10- Kamion me kapacitet mbajtes nga 5-7 ton me dy diferenciale**

Eshte kerkuar 1 kamion me dy diferenciale per transportin e materialeve te ndryshme per pritat ne zonat malore.

**11- Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 1.5-5 ton**

Eshte kerkuar 1 kamioncine per transportin e materialeve dhe punetoreve ne vendin e punes.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).